



Pranuar / Dorezuar Punëjeto/Prodato Received/Delivered	07.11.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org./Unit	Pr. Prot Pr. Prot	Shtujca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/STK	6773/2022		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.846/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani anëtarë, si dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.846/2022 të datës 03.10.2022 e parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit/Komuna e Mitrovicës së Jugut, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 07.11.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.846/2022 e datës 03.10.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Obligohet Kryetari i Komunës së Mitrovicës së Jugut, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi, të inicioj veprimet e nevojshme ligjore për harmonizimin e koeficientit të nëpunësit civil nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Komunën e Mitrovicës së Jugut, përmes postës më datë 29.09.2022 ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e cila është pranuar më datë 03.10.2022 dhe është regjistruar nën shenjën A.nr.864/2022

me numër protokollit 5821/2022, me pretendimet për harmonizim të koeficientit me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5).

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 06.10.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Mitrovicës së Jugut. Ndërsa Këshilli, me datë 11.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 5821/2022 të datës 03.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesën me numër reference: 01-120/04-0085506/22 të datës 16.09.2022 të ankuesit; Përgjigjen në kërkesë me numër reference: 01-120/04-0085506-2/22 të datës 26.09.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore; Akt Emërimit të datës 03.08.2020 në emër të ankuesit; Konkursin me numër të referencës RPC0003444 të datës 10.08.2022; Konkursin me numër të referencës RPC0002023 të datës 21.02.2022; Vendimin e Këshillit Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil me numër të lëndës A.nr.538/2022 të datës 27.07.2022 me numër të protokollit 4376; Zarin e datës 29.09.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesën e datës 06.10.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 11.10.2022; E-mail i datës 10.10.2022 i dërguar nga B.S drejtuar A.B me korrespondencën e bashkëngjitur prej 1-2 faqe; Fletë dorëzimi të datës 27.09.2022; Listën e pagave për muajin gusht dhe shatorë 2022; Akt emërimi të datës 03.08.2012 në emër të ankuesit; Përshkrim i detyrave të punës për pozitën Shef i Sektorit të Shërbimeve Komunale të datës 03.08.2012.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit, është e bazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka gjetur se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 03.08.2012 është i punësuar në pozitën *Shef i Sektorit të Shërbimeve Komunale*, në Komunën e Mitrovicës së Jugut me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5). I njëjti me datë 16.09.2022, parashtron kërkesë me numër reference: 01-120/04-0085506/22 tek Menaxheri i Burimeve Njerëzore për harmonizim (ngritje) të koeficientit nga koeficienti shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5), ndërsa me datë 26.09.2022 Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Mitrovicës së Jugut përmes përgjigjes me numër reference: 01-120/04-0085506-2/22 njofton ankuesin se pozitat për udhëheqës të sektorëve çdo herë i ka shpallur dhe rekrutuar duke u bazuar në katalogun e titujve të vendeve të punës, të cilët janë me gradën 7, sipas koeficientit 7.5.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon që Komuna duhet të bëjë harmonizimin e koeficientit të pagës nga shtatë pikë pesë (7.5) në koeficientin tetë pikë pesë (8.5) sikurse rastit të Shefi të Sektorit të Projekteve të Zhvillim Rural sipas vendimit të Këshillit A.nr.538/2022, pasi që për punën e njëjtë duhet vlejë paga e njëjtë sipas parimeve të përgjithshme të legjislacionit për pagat e nëpunësve civil.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 19 ku përcaktohet se: *Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e Pagave si dhe nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil me të cilin parashihet se: 1. E drejta e nëpunësve civil për pagë të drejtë dhe të rregullt është e garantuar në bazë të kushteve të përcaktuara me këtë ligj dhe me Ligjin e Shërbimit Civil. 2. Institucionet e administratës publike të Republikës së Kosovës janë të detyruara të paguajnë pagë të njëjtë për punën me vlerë të njëjtë....*, dhe rrjedhimisht konstatoj se e drejta në pagë është e drejtë themelore nga marrëdhënia e punës dhe nëpunësit civil të cilët kryejnë detyra të ngjashme të punës dhe që kanë kualifikime dhe përvojën e kërkuar për pozitën respektive, duhet të realizojnë pagë të njëjtë. Andaj, në vështrim të këtyre dispozitave si dhe bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se organi i punësimit respektivisht Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka unifikim të pagës për udhëheqësit e sektorëve pasi aplikohen koeficient të ndryshëm lidhur me këto pozita të kategorisë së njëjtë, gjegjësisht Kolegji nga provat materiale ka konstatuar se Udhëheqësi i Sektorit për Buxhet dhe Financa ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit Për Financa dhe Zhvillim Ekonomik ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Tatimit në Pronë ka koeficient 8.5 të pagës, Udhëheqësja e Zyrës për Informim ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Administratës dhe Financave ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit për Komunitete dhe Kthim ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Sekretarisë së Kuvendit ka koeficient 9 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit të Personelit ka koeficient 9.5 të pagës, Udhëheqësi i Sektorit Ligjor ka koeficient 9.5, ndërsa udhëheqësit e sektorëve të tjerë duke përfshirë edhe ankuesin si „Shef i Sektorit të Shërbimeve Komunale“ kanë koeficient 7.5 të pagës. Kështu që bazuar në këto fakte dhe konstatime, Kolegji vlerëson së aplikimi i koeficienteve jo të njëjtë të pagës për pozita të kategorive të njëjta, paraqet trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të stafit ashtu siç është përcaktuar me nenin 4 paragrafi 1 Ligjit Nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi ku thuhet se: *“Diskriminimi i drejtpërdrejtë konsiderohet kur një person trajtohet në mënyrë më pak të favorshme sesa trajtohet, ka qenë i trajtuar ose do të trajtohet një person tjetër në një situatë të krahasueshme, sipas një apo më shumë nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji”*, dhe se trajtimi jo i barabartë i të punësuarve të së njëjtës kategori brenda të njëjtit institucioni është në kundërshtim të plotë edhe me nenin 3 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil.

Nisur nga fakti së ankuesi ka qenë i emëruar në kohën kur ka qenë në fuqi Ligji Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, Kolegji ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.05/2012 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, dhe rrjedhimisht sipas nenit 14 të kësaj Rregullore pozita udhëheqës i sektorit përcaktohej si pozitë e nivelit drejtues një (1) me grada shtatë (7) të pagës, duke u evidentuar edhe në Katalogun e Vendeve të Punës (*i miratuar me datë 05.02.2015 i ndryshuar dhe plotësuar me 21.08.2018*), me EZHE/420 dhe gradë 7 të pagës.

Po ashtu bazuar në nenin 34 paragrafi 3 të Rregullores Nr. 05/2012 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, të gjitha institucionet e Republikës së Kosovës me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore kanë qenë të detyruar që të bëjnë klasifikimin, harmonizimin dhe standardizimin e pozitave në pajtim me dispozitat e kësaj rregullore.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave me rastin e shqyrtimi dhe vendosjes lidhur me këtë çështje, mori parasysh shkresën me numër DASHC/MAP-04/1571 02/ZPS/3851 të datës 20.11.2014 të lëshuar nga drejtori i Departamentit të Administrimit të Shërbimit Civil/MAP, për

Sekretarët e Përgjithshëm, drejtorët e Agjencive Ekzekutive dhe menaxherët e personelit të institucioneve publike përmes së cilës shkresë janë vendosur koeficientet e pozitive përkatëse rrjedhimisht për pozitën udhëheqës i sektorit është vendosur koeficient tetë pikë pesë (8.5).

Andaj, nisur nga gjendja faktike dhe juridike e konstatuar si me lartë, Kolegji vlerësoj se organi i punësimit gjegjësisht Komuna e Mitrovicës së Jugut me rastin e mos harmonizimit të koeficientit të pagës së ankuesit ka vepruar edhe kundërshtim me nenin 7 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, me të cilin është përcaktuar se: *Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe paanësisë politike, mos-diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë*, kështu që Kolegji vlerëson se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankuesit mbi bazën e harmonizimit të koeficientit të pagës me udhëheqësit e tjerë të sektorëve brenda komunës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerret të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës, duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.846/2022

Flakron GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- *Ankuesit*
- *Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Jugut;*
- *Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Jugut; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*

